- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.	Zhvillimi i Platformës dixhitale	1	copë		
2.	Implementimi i Platformës	1	copë		
3.	Trajnimi i punonjësve përdorues të Platformës	30	orë		
4	Mirëmbajtja e Platformës	24	muaj		
				Çmimi total	_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiruar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: Implementimi, zhvillimi dhe vënia në zbatim e Platformës dixhitale për trajtimin e ankesave të konsumatorëve. Ky shërbim përfshin edhe trajnimin e punonjësve përdorues të kësaj Platforme si dhe mirëmbajtjen e saj për një periudhë 24 (njëzet e katër) mujore.

Afatet e ekzekutimit: 4 (katër) muaj nga data e nënshkrimt të kontratës nga palët.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

1.1. Objektivi i Përgjithshëm

Objekti i përgjithshëm konsiston në zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi elektronik të centralizuar për administrimin, trajtimin, monitorimin dhe raportimin e ankesave dhe/ose kërkesave të paraqitura pranë Entit Rregullator të Energjisë ("ERE"), me qëllim zëvendësimin e modelit aktual manual, të bazuar kryesisht në tabela Excel dhe komunikime fizike, me një platformë funksionale që mundëson regjistrimin, kategorizimin, ndjekjen e statusit, administrimin e dokumentacionit, ruajtjen e kthim-përgjigjeve, monitorimin e afateve dhe gjenerimin e raporteve të strukturuar, për rritjen e transparencës, efikasitetin institucional, gjurmueshmërinë e plotë të praktikave dhe cilësinë e shërbimit ndaj klientëve dhe konsumatorëve.

1.2. Qëllimi Baza ligjore dhe kërkesat e përputhshmërisë

Qëllimi i zhvillimit të projektit

Qëllimi kryesor i këtij projekti është dixhitalizimi dhe përmirësimi i procesit të administrimit, trajtimit, monitorimit dhe raportimit të ankesave dhe/ose kërkesave të paraqitura pranë Entit Rregullator të Energjisë ("ERE"). Nëpërmjet zhvillimit të platformës elektronike do të mundësohet regjistrimi, administrimi dhe ndjekja e plotë e ciklit të jetës së çdo ankese apo kërkesë, nga momenti i paraqitjes deri në mbylljen përfundimtare të praktikës. Çdo praktikë do të ketë dosjen e saj elektronike, ku do të administrohen dokumentacioni përkatës, komunikimet, përgjigjet, afatet, statuset dhe veprimet e ndërmarra nga strukturat përgjegjëse. Projekti synon gjithashtu standardizimin e të dhënave dhe të proceseve të punës, me qëllim uljen e gabimeve njerëzore, shmangien e duplikimeve dhe rritjen e saktësisë së informacionit të administruar.

Një objektiv i rëndësishëm i sistemit është rritja e gjurmueshmërisë, transparencës dhe kontrollit të brendshëm. Çdo veprim i kryer në sistem duhet të jetë i regjistruar, i datuar dhe i lidhur me përdoruesin përkatës, duke krijuar një historik të plotë auditimi për çdo praktikë, vendimmarrje, komunikim apo ndryshim statusi.

Platforma do të kontribuojë në rritjen e efikasitetit institucional, duke automatizuar ndjekjen e statuseve, administrimin e përgjigjeve, monitorimin e afateve dhe përgatitjen e raporteve periodike. Në këtë mënyrë, ERE do të ketë mundësi të analizojë në mënyrë më të strukturuar numrin e ankesave/kërkesave, kategoritë kryesore, kohën e trajtimit, rezultatet e përfundimit dhe problematikat e përsëritura.

Zbatimi i këtij projekti pritet të përmirësojë cilësinë e shërbimit ndaj konsumatorëve dhe subjekteve që paraqesin ankesa apo kërkesa pranë ERE-s, duke mundësuar trajtim më të shpejtë, më të saktë dhe më transparent të tyre, në përputhje me kompetencat dhe procedurat institucionale të Entit.

Baza ligjore dhe kërkesat e përputhshmërisë

Sistemi që do të zhvillohet dhe vihet në funksionim duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për sektorin e energjisë, administrimin e bazave të të dhënave shtetërore, sigurinë e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Në veçanti, sistemi duhet të mbështesë ushtrimin e funksioneve të ERE-s sipas legjislacionit sektorial, përfshirë Ligjin Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe Ligjin Nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, mbi bazën e të cilëve Enti Rregullator i Energjisë (“ERE”), ushtron veprimtarinë e saj rregullatore.

Për procesin e trajtimit të ankesave dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, duhet të merret në konsideratë edhe Rregullorja e miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr.114, datë 08.07.2016, “Për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

Sistemi duhet të jetë në përputhje me Ligjin Nr.10 325, datë 23.09.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, i cili zbatohet për bazat e të dhënave që krijohen dhe administrohen nga institucionet publike. Gjithashtu, duhet të respektohen kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 945, datë 02.11.2012, “Për miratimin e rregullores ‘Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore’”, i ndryshuar, veçanërisht sa i përket disponueshmërisë, integritetit dhe konfidencialitetit të sistemit dhe të të dhënave. Duke qenë se sistemi do të përpunojë të dhëna të ankuesve, konsumatorëve, subjekteve të licencuara dhe përdoruesve institucionalë, ai duhet të jetë në përputhje edhe me Ligjin Nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

1.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Furnizuesi/Kontraktori

(“Kontraktori”) ose (“Furnizuesi”), duhet të realizojë, zhvillimin, zbatimin dhe vënien në funksion të një sistemi elektronik të centralizuar për administrimin, trajtimin, monitorimin dhe raportimin e ankesave dhe/ose kërkesave:

- Zhvillimin dhe vënien në funksion të një platforme elektronike të centralizuar për administrimin e ankesave dhe kërkesave, duke zëvendësuar procesin manual të bazuar në Excel dhe komunikime fizike;
- Modulin për regjistrimin dhe administrimin e ankesave/kërkesave, që mundëson evidentimin, kategorizimin dhe ruajtjen e të dhënave kryesore për çdo praktikë të paraqitur pranë institucionit;
- Modulin për ndjekjen e statusit të praktikave, i cili mundëson monitorimin e fazave të trajtimit, përgjegjësisve, afateve, veprimeve të ndërmarra dhe statusit përfundimtar të çdo ankesë/kërkesë;
- Modulin për administrimin elektronik të dokumentacionit, i cili duhet të mundësojë ngarkimin, ruajtjen, arkivimin dhe lidhjen e dokumenteve përkatëse me dosjen elektronike të çdo praktike;
- Modulin për administrimin elektronik të kthim-përgjigjeve dhe historikut të komunikimeve për çdo ankesë/kërkesë;
- Modulin për monitorimin e afateve dhe njoftimeve, për ndjekjen e afateve, evidentimin e vonesave dhe sinjalizimin e praktikave që kërkojnë veprim;

-
- Modulën e raportimit dhe analizës, për gjenerimin e raporteve të strukturuar mbi ankesat/kërkesat, statuset, afatet e trajtimit, subjektet përkatëse dhe problematikat e përsëritura;
 - Ndërfaqe për përdoruesit e brendshëm të ERE-s, për administrimin dhe monitorimin e praktikave sipas roleve dhe të drejtave të aksesit;
 - Ndërfaqen/aksesin për publikun ose konsumatorët, sipas kërkesave funksionale të projektit, për paraqitjen e ankesave/kërkesave, ngarkimin e dokumentacionit dhe/ose ndjekjen e statusit të praktikës;
 - Mekanizmat e gjurmueshmërisë dhe auditimit, në mënyrë që çdo veprim i kryer në sistem të jetë i regjistruar, i datuar dhe i lidhur me përdoruesin përkatës, duke garantuar transparencë dhe kontroll të brendshëm;
 - Migrimin ose strukturimin fillestar të të dhënave ekzistuese, sipas mundësisë dhe kërkesave të institucionit, nga formatet aktuale Excel në sistemin e ri elektronik;
 - Integrimet e nevojshme me sisteme, faqe zyrtare ose subjekte të treta, nëse parashikohet nga specifikimet teknike, për publikimin e të dhënave, shkëmbimin e informacionit ose ndjekjen e praktikave me operatorët përkatës;
 - Dokumentimin teknik dhe funksional të sistemit, përfshirë manualët e përdorimit, dokumentacionin e administrimit, përshkrimin e moduleve, rrjedhat e punës dhe udhëzimet për mirëmbajtje;
 - Trajnimin e përdoruesve dhe administratorëve të sistemit, me qëllim përdorimin korrekt të platformës, administrimin e praktikave dhe shfrytëzimin e funksioneve të raportimit dhe monitorimit;
 - Testimin, kolaudimin dhe dorëzimin përfundimtar të sistemit, duke verifikuar funksionalitetet, performancën, sigurinë, saktësinë e të dhënave dhe përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara;
 - Mirëmbajtjen dhe mbështetjen teknike të sistemit, për periudhën e përcaktuar në kontratë, duke përfshirë korrigjimin e problemeve, përditësimet e nevojshme, asistencën teknike dhe garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të platformës.

2. SUPOZIMET

2.1. Supozimet e Projektit

Në kuadër të zhvillimit të sistemit, një pjesë e të dhënave ekzistuese do të migrohen nga tabela Excel, dokumente fizike apo regjistra të shpërndarë drejt një baze të dhënash të strukturuar. Ky proces mund të kërkojë pastrim, standardizim dhe verifikim paraprak të të dhënave, për shkak të mundësisë që informacioni historik të jetë i paplotë, i përsëritur ose i regjistruar në formate të ndryshme.

Gjithashtu, zhvillimi i sistemit mund të kërkojë unifikimin e kategorive të ankesave, statuseve, afateve, roleve dhe hapave proceduralë. Në mungesë të proceseve të dokumentuara në mënyrë të njëtrajtshme, mund të lindin nevoja për saktësim të rrjedhave të punës, niveleve të autorizimit dhe përgjegjësi të përdoruesve. Një tjetër supozim lidhet me nevojën për garantimin e gjurmueshmërisë,

sigurisë dhe integritetit të të dhënave. Sistemi duhet të regjistrojë veprimet e përdoruesve, të parandalojë ndryshimet e paautorizuara, të mundësojë kontroll të aksesit sipas roleve dhe të sigurojë mbrojtjen e të dhënave personale dhe institucionale.

Për shkak të rëndësisë së procesit institucional që do të mbështetet nga sistemi, duhet të sigurohen performancë, disponueshmëri dhe rikuperim i përshtatshëm në rast defekti. Kjo përfshin kapacitetin për të përballuar ngarkesën e përdoruesve, praktikave, dokumenteve dhe raporteve, si dhe zbatimin e politikave të backup-it dhe rikthimit të të dhënave.

Sistemi duhet të mundësojë administrimin elektronik të dokumentacionit për çdo praktikë, përfshirë ruajtjen, indeksimin, versionimin dhe lidhjen e dokumenteve me dosjen përkatëse. Cilësia e të dhënave të regjistruara do të ndikojë drejtpërdrejt edhe në saktësinë e raporteve institucionale dhe analizave mbi ankesat, afatet, rezultatet dhe problematikat e përsëritura.

Nëse parashikohet ndërveprim me sisteme të tjera institucionale apo shërbime të jashtme, mund të kërkohej zhvillimi i ndërfaqeve të sigurta API, përcaktimi i formateve të shkëmbimit të të dhënave dhe mekanizmave të autentifikimit. Po ashtu, sistemi duhet të parashikojë masa për mbrojtjen nga rreziqet e sigurisë kibernetike, përfshirë aksesin e paautorizuar, manipulimin e të dhënave dhe keqpërdorimin e kredencialeve.

Së fundmi, përdoruesit do të kenë nevojë për përshtatje me sistemin e ri, pasi proceset janë kryer më parë në mënyrë manuale. Për këtë arsye, sistemi duhet të jetë i thjeshtë në përdorim, i përshtatur me rrjedhat reale të punës dhe i ndërtuar mbi një arkitekturë të qëndrueshme, të mirëdokumentuar dhe të zgjerueshme për nevoja të ardhshme.

3. QËLLIMI I PUNËS

3.1. Të Përgjithshme

Ky projekt bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore si më poshtë:

- Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”;
- Ligjin Nr.9918, datë 19.5.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligj Nr.9887, datë 10.03.2008, ndryshuar “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Ligji Nr.10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
- Vendim Nr.734, datë 28.8.2013 “Për krijimin e sistemit unik të regjistrimit, autentifikimit dhe identifikimit të përdoruesve në marrjen e shërbimeve publike nga sistemet elektronike.”;
- Vendim Nr.710, datë 21.8.2013 “Për Krijimin dhe Funksonimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”, i ndryshuar;
- Vendim Nr.945, datë 02.11.2012, “Për Miratimin e Rregullores “Administrimi i sistemit te bazave te të dhënave shtetërore”, të ndryshuar;

3.2. Përshkrimi i Detyrës

Për mbledhjen, analizimin dhe gjenerimin e raporteve të nevojshme mbi të dhënat e administruara, (“ERE”) do të pajiset me një platformë web të centralizuar, e cila do të jetë në zotërim dhe administrim të plotë nga institucioni. Platforma do të shërbejë për administrimin elektronik të

ankesave, kërkesave, dokumentacionit, komunikimeve, afateve dhe raporteve përkatëse. Krahas saj, do të zhvillohet edhe një ndërfaqe web publike, e cila do të përdoret për publikimin e informacionit dhe rritjen e transparencës, përfshirë transparencën mbi çmimin e energjisë, sipas kërkesave funksionale të projektit.

Kontraktori/Furnizuesi duhet të realizojë të gjitha detyrat në përputhje me kërkesat teknike, funksionale dhe detyrimet kontraktuale. Në fazën paraprake, në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor, ai duhet të analizojë dokumentacionin ekzistues, infrastrukturën teknike, kuadrin rregullator dhe bazën ligjore të zbatueshme, si dhe proceset aktuale të punës së ERE-s, me qëllim përcaktimin e saktë të kërkesave për zhvillimin e sistemit.

Pas përfundimit të fazës së analizës, Kontraktori/Furnizuesi duhet të vijojë me zhvillimin e platformës web dhe moduleve përkatëse, përfshirë konfigurimin e funksionaliteteve, krijimin dhe integrimin e përdoruesve të nevojshëm, si dhe, kur kërkohet, përdoruesve të operatorëve të tregut të energjisë. Gjithashtu, ai duhet të realizojë trajnimin e punonjësve dhe administratorëve të ERE-s, me qëllim përdorimin korrekt të sistemit dhe administrimin efektiv të praktikave. Në fazën përfundimtare, Kontraktori/Furnizuesi duhet të kryejë implementimin e sistemit në serverat e ERE-s, testimin dhe kolaudimin e tij, si dhe publikimin e ndërfaqes publike në një nën-domen të faqes zyrtare www.ere.gov.al, sipas specifikimeve teknike dhe miratimit të Autoritetit Kontraktor.

3.3. Grupet e synuara

Ky projekt synon grupet e poshtë-përmendura:

- Konsumatorët dhe publiku i gjerë;
- Përdoruesit e brendshëm të ERE-s;
- Administratorët e sistemit pranë ERE-s;
- Operatorët dhe subjektet e licencuara të tregut të energjisë;
- Strukturat vendimmarrëse të ERE-s;
- Strukturat e auditimit dhe kontrollit të brendshëm;

3.4. Siguria e sistemit

Sistemi duhet të projektohet dhe implementohet në përputhje me parimet e sigurisë së informacionit, duke garantuar disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave gjatë gjithë ciklit të përpunimit të tyre. Platforma duhet të jetë e qëndrueshme dhe e besueshme, të parandalojë aksesin dhe ndërhyrjet e paautorizuara, si dhe të sigurojë kontroll të vazhdueshëm mbi ruajtjen, transmetimin dhe përpunimin e informacionit.

Sistemi duhet të ofrojë mekanizma të qartë për administrimin e përdoruesve, profileve dhe roleve, duke mundësuar përcaktimin e të drejtave të aksesit në nivel moduli dhe në nivel të dhënash. Të drejtat duhet të përfshijnë, sipas rastit, leximin, shkrimin, kërkimin, printimin, eksportimin, miratimin ose veprime të tjera funksionale, në varësi të profilit të përdoruesit dhe përgjegjësive të tij në procesin e trajtimit të ankesave/kërkesave. Më specifikisht, sistemi duhet të mundësojë:

- *Administrimin dhe konfigurimin e sistemit.* Sistemi duhet të ofrojë funksionalitete për krijimin, përditësimin dhe menaxhimin e profileve të përdoruesve, si dhe konfigurimin e parametrave kryesorë të platformës.

-
- *Menaxhimin e roleve.* Sistemi duhet të lejojë caktimin e një ose më shumë roleve për çdo përdorues, duke përcaktuar qartë funksionalitetet, modulet dhe të dhënat që ai mund të aksesojë.
 - *Menaxhimin e përdoruesve.* Sistemi duhet të mundësojë miratimin, aktivizimin, bllokimin, zhbllokimin dhe përditësimin e llogarive të përdoruesve, në përputhje me të drejtat administrative të përcaktuara.
 - *Auditimin e përdoruesve.* Sistemi duhet të ruajë historikun e veprimeve të kryera nga përdoruesit, përfshirë aksesimet, ndryshimet, miratimet, fshirjet, eksportimet dhe veprime të tjera të rëndësishme në platformë.
 - *Administrimin e fjalëkalimeve.* Sistemi duhet të garantojë mbrojtjen e fjalëkalimeve përmes mekanizmave të sigurt të hashimit/enkriptimit, si dhe të mbështesë politika për kompleksitetin, ndryshimin dhe rikuperimin e tyre.
 - *Komunikimin e sigurt.* Sistemi duhet të mbështesë komunikim të sigurt përmes protokolleve HTTPS/SSL/TLS ose ekuivalente, me qëllim mbrojtjen e të dhënave gjatë transmetimit ndërmjet përdoruesit, aplikacionit dhe komponentëve të tjerë të sistemit.
 - *Gjurmimin e sesioneve.* Sistemi duhet të ruajë gjurmë kohore për hyrjet dhe daljet nga sistemi, përfshirë “timestamp” të login/logout, përdoruesin përkatës dhe, kur është teknikisht e mundur, adresën IP ose burimin e aksesit.
 - *Panelin për korrigjimin dhe verifikimin e gabimeve.* Sistemi duhet të ofrojë një panel të dedikuar për identifikimin, verifikimin dhe korrigjimin e gabimeve në hedhjen e të dhënave ose të veprimeve të kryera gabimisht nga përdoruesit. Për çdo ndërhyrje korrigjuese duhet të ruhen log-et përkatëse, përdoruesi përgjegjës, koha e veprimit dhe një koment tekst që përshkruan arsyen dhe natyrën e korrigjimit.

Grupet kryesore të përdoruesve të Platformës Dixhitale për Trajtimin e Ankesave të Konsumatorëve përcaktohen si më poshtë:

- Administratorët e sistemit;
- Përdoruesit e brendshëm të ERE-s;
- Personat përgjegjës për shqyrtimin e ankesave/kërkesave;
- Operatorët e tregut të energjisë;
- Drejtuesit/përdoruesit mbikëqyrës.

Sistemi duhet të ofrojë këto nivele të përdoruesve:

STRUKTURA E NIVELEVE TË PËRDORUESVE TË PLATFORMËS

Platforma Dixhitale për Trajtimin e Ankesave të Konsumatorëve



Disponueshmëria	Integriteti	Konfidencialiteti	Niveli i Sigurisë
<input type="checkbox"/> D0	<input type="checkbox"/> I0	<input type="checkbox"/> K0	
<input type="checkbox"/> D1	<input type="checkbox"/> I1	<input type="checkbox"/> K1	<input type="checkbox"/> U
<input checked="" type="checkbox"/> D2	<input type="checkbox"/> I2	<input checked="" type="checkbox"/> K2	<input type="checkbox"/> M
<input type="checkbox"/> D3	<input checked="" type="checkbox"/> I3		<input checked="" type="checkbox"/> L

Për të garantuar nivelin e kërkuar të sigurisë, sistemi duhet të përmbushë specifikimet e mëposhtme teknike:

Sistem autentifikimi dhe autorizimi

- Platforma duhet të lejojë akses vetëm për përdoruesit e autorizuar, përmes mekanizmave të sigurt të autentifikimit me kredenciale individuale, si emër përdoruesi dhe fjalëkalim.
- Sistemi duhet të mbështesë menaxhimin e roleve dhe të drejtave të aksesit, në mënyrë që çdo përdorues të ketë qasje vetëm në funksionalitetet, modulet dhe të dhënat që lidhen me rolin e tij.
- Platforma duhet të mundësojë politika të kontrollit të aksesit sipas parimit “least privilege”, duke kufizuar të drejtat vetëm në nivelin e nevojshëm për kryerjen e detyrave përkatëse.
- Sistemi duhet të parashikojë menaxhim të sesioneve të përdoruesve, përfshirë skadimin automatik të sesionit pas periudhave të pasivitetit dhe mbrojtjen ndaj përdorimit të paautorizuar të kredencialeve.

Sistem enkriptimi

- Sistemi duhet të garantojë enkriptimin e të dhënave gjatë transmetimit, duke përdorur protokolle të sigurta komunikimi ndërmjet përdoruesit fundor, aplikacionit, komponentëve të brendshëm dhe bazës së të dhënave.
- Të dhënat sensitive dhe personale duhet të mbrohen gjatë ruajtjes, përmes mekanizmave të përshatshëm të enkriptimit ose masave të tjera ekuivalente të sigurisë.
- Fjalëkalimet nuk duhet të ruhen në formë të lexueshme në bazën e të dhënave dhe duhet të mbrohen përmes algoritmeve të sigurta të hashimit dhe kriptimit, sipas praktikave më të mira të sigurisë.
- Sistemi duhet të mbështesë mekanizma për mbrojtjen e kredencialeve, përfshirë kompleksitetin minimal të fjalëkalimeve, kufizimin e tentativave të dështuara dhe ndryshimin periodik të tyre, sipas politikave të miratuara.

Sistemi i logeve

- Platforma duhet të mundësojë regjistrimin e veprimeve kryesore të kryera në sistem, me qëllim gjurmueshmërinë, kontrollin e brendshëm dhe auditimin e proceseve. Log-et duhet të përmbajnë minimalisht këto të dhëna:
 - Koha e veprimit
 - Përdoruesi
 - Moduli
 - Veprimi
 - Adresa/IP ose burimi i aksesit, kur është teknikisht e mundur
 - Rezultati i veprimit, si i suksesshëm ose i pasuksesshëm
- Sistemi duhet të mundësojë ruajtjen e log-eve në mënyrë të sigurt, me qëllim identifikimin e ndryshimeve, aksesimeve, modifikimeve apo ndërhyrjeve të mundshme në të dhëna.
- Platforma duhet të regjistrojë edhe ndryshimet e kryera në bazën e të dhënave, në mënyrë që të identifikohen modifikimet e mundshme të realizuara jashtë ndërfaqes së aplikacionit.
- Log-et duhet të jenë të mbrojtura nga ndryshimi ose fshirja e paautorizuar dhe të ruhen për një periudhë të përcaktuar sipas politikave të institucionit dhe kërkesave ligjore në fuqi.

Elemente shitesë të sigurisë së sistemit

- Sistemi duhet të përfshijë mekanizma për validimin e të dhënave hyrëse, me qëllim parandalimin e sulmeve të zakonshme ndaj aplikacioneve web, si SQL Injection, Cross-Site Scripting dhe manipulimi i kërkesave.
- Platforma duhet të sigurojë ndarje të qartë ndërmjet mjediseve të zhvillimit, testimit dhe prodhimit, duke kufizuar aksesin vetëm për personat e autorizuar.
- Sistemi duhet të mundësojë backup periodik të të dhënave dhe rikuperim në rast defekti, incidenti teknik ose humbjeje të informacionit.
- Duhet të parashikohen mekanizma për monitorimin e disponueshmërisë, performancës dhe incidenteve të sigurisë, me qëllim identifikimin dhe trajtimin në kohë të problematikave.
- Platforma duhet të mbështesë konfigurime të sigurt të serverëve, bazës së të dhënave dhe komponentëve të aplikacionit, duke kufizuar shërbimet, portat dhe privilegjet e panevojshme.
- Sistemi duhet të projektohet në mënyrë që të garantojë konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e sigurisë së informacionit.

3.5. Detyrat specifike

Projekti, do ti nënshtrohet 10 (dhjetë) fazave që paraqiten si mëposhtë:

Faza I: Analizimi i kërkesave paraprake dhe miratimi i proçeseve

Në këtë fazë, Kontraktori/Furnizuesi, në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktor, duhet të analizojë dokumentacionin ekzistues, proceset aktuale të punës, infrastrukturën teknike, kuadrin rregullator dhe bazën ligjore të zbatueshme. Qëllimi është identifikimi i kërkesave funksionale, teknike, të sigurisë dhe raportimit që duhet të mbështesë platforma.

Faza II: Faza e projektimit funksional dhe teknik

Pas analizës fillestare, duhet të hartohet projektimi i sistemit, duke përfshirë arkitekturën teknike, modulet kryesore, rrjedhat e punës, rolet e përdoruesve, të drejtat e aksesit, strukturën e bazës së të dhënave dhe mekanizmat e sigurisë. Në këtë fazë përcaktohen edhe mënyra e administrimit të ankesave/kërkesave, statuset, afatet dhe raportet që do të gjenerohen nga sistemi.

Faza III: Zhvillimi i platformës

Në këtë fazë realizohet zhvillimi i platformës web dhe moduleve përkatëse, përfshirë modulën e regjistrimit të ankesave/kërkesave, ndjekjen e statusit, administrimin elektronik të dokumentacionit, historikun e komunikimeve, monitorimin e afateve, njoftimet automatike, raportimin dhe ndërfaqet për përdoruesit e brendshëm dhe publikun.

Faza IV: Konfigurimi dhe Integrimi

Gjatë kësaj faze do të realizohet konfigurimi teknik i sistemit në përputhje me kërkesat funksionale dhe operative të ERE-s. Procesi përfshin parametrizimin e platformës, krijimin e strukturës së

përdoruesve, konfigurimin e roleve, përcaktimin e të drejtave të aksesit dhe zbatimin e politikave të autorizimit sipas parimit të kontrollit të bazuar në role RBAC. Në këtë fazë do të konfigurohen gjithashtu modulet kryesore të sistemit, rrjedhat e punës, statuset e praktikave, afatet procedurale, njoftimet automatike dhe nivelet e miratimit. Konfigurimet mund të realizohen nëpërmjet skedarëve të konfigurimit, p.sh. JSON/YAML ose ekuivalente, parametrave në bazën e të dhënave, si dhe përmes ndërfaqeve administrative të platformës. Nws parashikohet gjatw fazws sw I-rw tw analizimit do tw kryhen edhe integrimet me sisteme të tjera institucionale, faqe zyrtare, nën-domene, shërbime API ose subjekte të treta.

Këto integrimet mund të realizohen përmes REST API/Web Services, mekanizmave të autentifikimit si OAuth2/JWT, si dhe shkëmbimit të të dhënave në formate standarde si JSON/XML ose ekuivalente. Në këtë fazë mund të përfshihet edhe krijimi dhe konfigurimi i llogarive për operatorët e tregut të energjisë, duke përcaktuar për secilin përdorues nivelin e aksesit, modulet e lejuara, të drejtat për konsultim, ngarkim dokumentacioni, ndjekje statusi apo ndërveprim me praktikatat përkatëse në platformë.

Faza V: Migrimi dhe strukturimi i të dhënave

Nëse parashikohet nga kërkesat e projektit, realizohet migrimi dhe/ose strukturimi fillestar i të dhënave ekzistuese nga burimet aktuale, si tabela Excel, regjistra të shpërndarë, arkiva elektronike apo dokumentacion fizik i dixhitalizuar, drejt bazës së të dhënave të platformës së re. Kjo fazë përfshin identifikimin e burimeve të të dhënave, analizën e strukturës ekzistuese, përcaktimin e modelit të ri të të dhënave, procesin e pastrimit, deduplikimit, normalizimit dhe standardizimit të informacionit, si dhe mapimin e fushave përkatëse me strukturën e sistemit të ri.

Përpara importimit në platformë, të dhënat duhet t'i nënshtrohen verifikimit të cilësisë, kontrollit të integritetit dhe validimit teknik, me qëllim shmangien e pasaktësive, mungesave apo mospërputhjeve gjatë ngarkimit në sistem. Procesi i migrimit duhet të realizohet në mënyrë të kontrolluar përmes skedarëve të strukturuar, procedurave të importimit, skripteve të migrimit ose mekanizmave të tjerë teknikë të miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

Faza VI: Testimi dhe Verifikimi

Platforma duhet t'i nënshtrohet një procesi të plotë testimi, verifikimi dhe auditimi teknik përpara vënies në funksion. Ky proces duhet të përfshijë testimin funksional, testimin teknik, testimin e sigurisë, testimin e performancës, testimin e integritetit dhe testimin e pranimin nga përdoruesit fundorë. Gjatë kësaj faze duhet të verifikohet përputhshmëria e çdo moduli me kërkesat funksionale dhe teknike të miratuara, funksionimi korrekt i rrjedhave të punës, menaxhimi i roleve dhe të drejtave të aksesit, ruajtja dhe përpunimi i saktë i të dhënave, si dhe gjenerimi i raporteve në formatin dhe strukturën e kërkuar.

Në aspektin e sigurisë, sistemi duhet të testohet për autentifikimin, autorizimin, menaxhimin e sesioneve, kontrollin e aksesit, enkriptimin e të dhënave, mbrojtjen ndaj ndërhyrjeve të paautorizuara dhe regjistrimin e veprimeve në log-e. Testimi duhet të përfshijë, sipas rastit, kontrolle për vulnerabilitete të zakonshme të aplikacioneve web, si SQL Injection, Cross-Site Scripting, Cross-Site Request Forgery dhe keqkonfigurime të aksesit.

Në lidhje me performancën, duhet të realizohen testime për kohën e përgjigjes së sistemit, ngarkesën e përdoruesve, përpunimin e praktikave, ngarkimin e dokumenteve dhe gjenerimin e raporteve. Rezultatet e testimit duhet të dokumentohen në procesverbalet përkatëse, duke evidentuar

gjetjet, korrigjimet e kryera dhe konfirmimin përfundimtar të gatishmërisë së platformës për implementim.

Faza VII: Trajnimi i Përdorueseve

Kontraktori/Furnizuesi duhet të trajnojë përdoruesit dhe administratorët e sistemit për përdorimin korrekt të platformës, administrimin e praktikave, ndjekjen e afateve, gjenerimin e raporteve dhe përdorimin e funksioneve të monitorimit. Trajnimi duhet të shoqërohet me manualin e përdorimit.

Faza VIII: Implemetimi dhe Publikimi

Pas të fazës së testimit, verifikimit funksional dhe miratimit nga Autoriteti Kontraktor, sistemi do të implementohet në serverat e ERE-s ose në infrastrukturën teknike të përcaktuar dhe miratuar për këtë qëllim. Implementimi duhet të përfshijë instalimin, konfigurimin e komponentëve të aplikacionit, konfigurimin e bazës së të dhënave, parametrizimin e mjedisit të prodhimit, si dhe verifikimin e funksionimit të platformës në kushte reale operimi. Gjatë kësaj faze, Kontraktori/Furnizuesi duhet të sigurojë kalimin e kontrolluar të sistemit nga mjedisi i testimit në mjedisin final të përdorimit, duke garantuar integritetin e të dhënave, funksionimin e moduleve, konfigurimin e roleve dhe të drejtave të aksesit, si dhe aktivizimin e mekanizmave të sigurisë, logimit, backup-it dhe monitorimit.

Ndërfaqja publike, nëse është pjesë e objektit të kontratës, do të publikohet në një nën-domen të faqes zyrtare www.ere.gov.al, sipas specifikimeve teknike, standardeve të sigurisë dhe miratimit përkatës nga Autoriteti Kontraktor. Publikimi duhet të realizohet pas verifikimit të aksesueshmërisë, performancës, sigurisë së komunikimit dhe përputhshmërisë me kërkesat funksionale të përcaktuara.

Faza IX: Auditimi dhe Dorëzimi Përfundimtar

Në këtë fazë realizohet përfundimtar teknik dhe funksional i sistemit, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së platformës me specifikimet teknike të miratuara, kërkesat funksionale, kriteret e sigurisë, standardet e gjurmueshmërisë, integritetit të të dhënave dhe detyrimet kontraktuale. Procesi i auditimit përfshin kontrollin e funksionaliteteve kryesore të sistemit, konfigurimeve, roleve dhe të drejtave të aksesit, mekanizmave të autentifikimit dhe autorizimit, log-eve të auditimit, ruajtjes së historikut të veprimeve, performancës së sistemit, si dhe saktësisë së të dhënave dhe raporteve të gjeneruara.

Pas përfundimit të verifikimeve dhe adresimit të çdo konstatimi eventual, sistemi dorëzohet zyrtarisht nga Kontraktori/Furnizuesi, së bashku me dokumentacionin teknik dhe funksional, manualin e përdorimit dhe administrimit, konfigurimet përkatëse, evidencat e testimit dhe raportin e auditimit.

Faza X: Mirëmbajtja e Platformës

Marrëveshja e mirëmbajtjes dhe mbështetjes teknike të sistemit do të ketë kohëzgjatje 2 (dy) vjet, sipas përcaktimeve të kontratës, dhe do të zbatohet në përputhje me VKM Nr.710, datë 21.08.2013, i ndryshuar, duke garantuar funksionimin e qëndrueshëm të sistemit, ruajtjen e informacionit, vazhdueshmërinë e shërbimit, rikuperimin në rast defekti dhe respektimin e niveleve të dakordësuara të shërbimit.

4. LOGJISTIKA DHE KOHA

4.1. Vendndodhja

Platforma do të vendoset dhe konfigurohet në mjedisin serverik të Autoritetit Kontraktor ose në infrastrukturën teknike të dedikuar, të përcaktuar dhe miratuar paraprakisht për implementimin dhe operimin e sistemit.

4.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e fillimit të zbatimit të kontratës do të konsiderohet data e nënshkrimit të saj ose çdo datë tjetër e përcaktuar shprehimisht në kontratë. Afati për realizimin, zhvillimin, implementimin, testimin dhe dorëzimin e sistemit do të jetë **4 (katër) muaj** nga data e fillimit.

Pas vënies në funksion dhe pranimit përfundimtar të sistemit, Kontraktori/Furnizuesi do të ofrojë shërbime mirëmbajtjeje dhe mbështetje teknike për një periudhë 2 (dy) vjeçare, sipas kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në kontratë.

5. RAPORTIMI

5.1. Kërkesat e Raportimit

Kontraktuesi do të paraqesë raportin e mëposhtme në shqip në origjinal dhe 2 (dy) kopje:

- **Drafti i Raportit Përfundimtar** prej maksimumi 15 faqesh (*teksti kryesor, duke përjashtuar anekset*). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se 10 ditë para përfundimit të periudhës së Kontratës.
- **Raporti Përfundimtar** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, përfshirë përshatjet sipas komenteve të pranuar nga palët në draft-raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është rreth 5 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

Çdo dokumentacion tjetër mbështetës që konsiderohet i nevojshëm për përgatitjen dhe vlerësimin e raporteve, përfshirë, por pa u kufizuar në:

- *Procesverbalin e gjetjeve fillestare;*
- *Procesverbalin e skenarëve të testimit;*
- *Manualin e trajnimit të përdoruesve;*

5.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raportit

Raportet e sipërpërmendura duhet t'i paraqiten Komisionit të Marrjes në Dorëzim, i cili do të ketë përgjegjësinë për ndjekjen, verifikimin dhe monitorimin e zbatimit të kontratës, si dhe për shqyrtimin dhe miratimin e raporteve përkatëse.

6. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Për të mbështetur funksionalitetet bazë të administrimit të të dhënave, si krijimi, leximi, përditësimi dhe fshirja e tyre (CRUD), sistemi duhet të ofrojë ndërfaqe komunikimi RESTful API, të sigurta dhe të dokumentuara, për shkëmbimin e të dhënave me sisteme të tjera të brendshme ose të jashtme.

Integrimi me bazën e të dhënave duhet të realizohet përmes mekanizmave të sigurt, të shpejtë dhe të kontrolluar të aksesit, duke përdorur teknologji standarde lidhjeje si ODBC, JDBC ose ndërfaqe të

tjera ekuivalente. Sistemi duhet të sigurojë sinkronizimin e të dhënave dhe dokumenteve me sistemet ekzistuese ose të reja të ERE-s, në mënyrë që informacioni të jetë i përditësuar dhe i aksesueshëm nga sistemet përkatëse. Për komunikimin dhe përditësimin në kohë reale të të dhënave, sistemi mund të mbështesë mekanizma të mesazhimit asinkron, si MQTT, AMQP ose teknologji të ngjashme, me qëllim reduktimin e vonesave dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet komponentëve.

7. MIRËMBAJTJA

Marrëveshja për shërbimin e mirëmbajtjes dhe mbështetjes teknike të sistemit do të ketë kohëzgjatje 2 (dy) vjeçare, sipas përcaktimeve të dokumentacionit të projektit dhe/ose kontratës. Ky shërbim do të realizohet në përputhje me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.710, datë 21.08.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar, duke përfshirë garantimin e funksionimit të qëndrueshëm të sistemit, ruajtjen e informacionit, vazhdueshmërinë e shërbimit, rikuperimin në rast defekti, si dhe respektimin e niveleve të dakordësuara të shërbimit.

7.1. Shërbimet e Mirëmbajtjes

(“Kontraktori”) ose (“Furnizuesi”), duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas kërkesave më poshtë:

- Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese. (“Kontraktori”) ose (“Furnizuesi”), duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në tre muaj, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për software-in. Shërbimet Parandaluese, janë shërbime proaktive të cilat do të mundësojnë detektimin në kohë të problematikave, dhe do mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit.
- Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e autoritetit kontraktor/perfituesit) (“Kontraktori”) ose (“Furnizuesi”), duhet të jetë i disponueshëm gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Premte, 8x5, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të “Alarmeve Madhore” të raportuara nga personeli i autorizuar (“Emergency On-Call Hours”). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të software-it, që e pengon atë të operojë në përputhje me specifikimet dhe shkakton ndërprerje të sistemit.

(i) Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore. Personat përgjegjës do të njoftojë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet ndonjë ndërfaqeje web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga (“Kontraktori”) ose (“Furnizuesi”) me telefon gjatë “Emergency On-Call Hours”. (“Kontraktori”) ose (“Furnizuesi”), duhet të kontaktojë personelin përgjegjës dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar.

(ii) Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore. Nëse (“Kontraktori”) ose (“Furnizuesi”), nuk mund të përcaktojë shkakun e defektit nga komunikimi me personelin e autorizuar, atëherë ai duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi pranë Autoritetit Kontraktor/Përfituesit brenda intervalit kohor prej 4 orësh nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, eksperti i (“Kontraktorit”) ose (“Furnizuesit”), do të mbështetet me asistencë nga personeli i autorizuar dhe do t’i jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, i shoqëruar dhe

1.	Faza e Analizës Paraprake të Kërkesave dhe Hartimit të Arkitekturës së Platformës							
2.	Faza e zhvillimit të arkitekturës dhe moduleve funksionale të platformës							
3.	Faza e konfigurimit dhe integrimit të platformës							
4.	Faza e zhvillimit dhe konfigurimit të platformës në ambientin e ERE-s							
5.	Faza e Testimit Funksional, Testimit të Sigurisë dhe Auditimit të Platformës							
6.	Trajnimi i Përdoruesve të Platformës							
7.	Periudha e mirëmbajtjes 24-mujore do të fillojë nga data e nënshkrimit të aktit të marrjes në dorëzim/kolaudit përfundimtar të sistemit nga AK.							

9. TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Të gjitha të drejtat mbi kodin burim, konfigurimet dhe dokumentacionin teknik të sistemit do t'i kalojnë Autoritetit Kontraktor. Sistemi duhet të dorëzohet me kod burim të strukturuar, të komentuar

dhe të gatshëm për mirëmbajtje, së bashku me dokumentacionin teknik të plotë, duke përfshirë përshkrimin e moduleve, arkitekturën, konfigurimet, varësitë teknologjike.

10. KËRKESAT FUNKSIONALE

10.1 Sistemi do të ndërtohet dhe organizohet kryesisht mbi këto module funksionale:

Nr.	Emërtimi i Modullit	Funksionalitetet teknike kryesore	Teknologjia e rekomanduar
1.	Moduli i administrimit të përdoruesve dhe roleve	Krijimi, përditësimi, aktivizimi, bllokimi dhe çaktivizimi i përdoruesve; menaxhimi i profileve; caktimi i roleve dhe të drejtave të aksesit në nivel moduli dhe funksionaliteti; administrimi i grupeve të përdoruesve.	Backend: Java / .NET / Node.js ose ekuivalente Frontend: React / Angular ose ekuivalente Database: PostgreSQL / SQL Server ose ekuivalente
2.	Moduli i autentifikimit dhe sigurisë së aksesit	Autentifikim me kredenciale të sigurta; autorizim sipas roleve; menaxhim sesionesh; politika fjalëkalimesh; hashim i fjalëkalimeve; kontrolli i aksesit; mbështetje për HTTPS/SSL/TLS; regjistrim i login/logout.	Backend: Java Spring Security / .NET Identity / Node.js JWT ose ekuivalente Security: JWT, OAuth2, RBAC, TLS ose ekuivalente Database: PostgreSQL / SQL Server ose ekuivalente
3.	Moduli i regjistrimit të ankesave/kërkesave	Regjistrimi elektronik i ankesave/kërkesave; plotësimi i formularëve; kategorizimi i praktikave; gjenerimi i numrit unik të çështjes; validimi i të dhënave; lidhja e praktikës me konsumatorin/subjektin përkatës.	Backend: Java / .NET / Node.js ose ekuivalente Frontend: React / Angular ose ekuivalente Database: PostgreSQL / SQL Server ose ekuivalente
4.	Moduli i workflow-it dhe afateve procedurale	Konfigurimi i rrjedhave të punës; caktimi i përgjegjësve; ndjekja e statusit të praktikës; menaxhimi i afateve; eskalimi i vonesave; njoftime automatike; kalimi i praktikës ndërmjet fazave të trajtimit.	Backend: Java / .NET / ose ekuivalente Workflow Engine: jBPM / Temporal / Custom Workflow ose ekuivalente Frontend: React / Angular ose ekuivalente
5.	Moduli i administrimit të dokumentacionit elektronik	Ngarkimi, ruajtja, indeksimi dhe arkivimi i dokumenteve; lidhja e dokumenteve me dosjen elektronike; versionimi; kontrolli i formateve dhe madhësisë së skedarëve; shkarkimi dhe shikimi i dokumenteve sipas të drejtave të aksesit.	Backend: Java / .NET / Node.js ose ekuivalente File Storage: File System / Object Storage / S3-compatible storage ose ekuivalente Database: PostgreSQL / SQL Server ose ekuivalente
6.	Moduli i komunikimeve dhe kthim-përgjigjeve	Administrimi i komunikimeve me konsumatorët dhe operatorët; krijimi i përgjigjeve; ruajtja e historikut të komunikimeve; njoftime me email (<i>nëse kërkohet</i>) regjistrimi i kërkesave për plotësim dokumentacioni.	Backend: Java / .NET / Node.js ose ekuivalente Integrime: SMTP, API ose ekuivalente Frontend: React / Angular ose ekuivalente
7.	Moduli për operatorët e jashtëm / subjektet e licencuara	Akses i kufizuar për operatorët/subjektet e licencuara; shikimi i praktikave që lidhen me subjektin përkatës; ngarkimi i dokumentacionit; dhënia e përgjigjeve; ndjekja e statusit dhe njoftimeve për çështjet përkatëse.	Backend: Java / .NET / Node.js ose ekuivalente Security: RBAC, API Security, HTTPS/TLS ose ekuivalente Frontend: React / Angular ose ekuivalente

8.	Moduli i ndërfaqes publike për konsumatorët	Formular publik për paraqitjen e ankesave/kërkesave; ngarkim dokumentesh mbështetëse; verifikim i të dhënave hyrëse; ndjekje e statusit të praktikës; marrje njoftimesh ose përgjigjesh nga institucioni.	Frontend publik: React / Angular / Vue.js ose ekuivalente Backend API: Java / .NET / Node.js ose ekuivalente Security: Captcha, input validation, HTTPS ose ekuivalente
9.	Moduli i raportimit dhe analizës	Gjenerimi i raporteve statistikore dhe analitike; filtrimi sipas periudhës, kategorisë, statusit, operatorit, afatit dhe rezultatit; eksportim në Excel/PDF; dashboard-e për monitorim institucional dhe vendimmarrje.	Backend: Java / .NET ose ekuivalente Reporting: JasperReports / Power BI Embedded Metabase / Custom Reports ose ekuivalente Frontend: React / Angular ose ekuivalente Database: PostgreSQL / SQL Server ose ekuivalente
10.	Moduli i publikimit dhe transparencës	Publikimi i njoftimeve, formularëve, udhëzimeve dhe informacioneve publike; publikimi i të dhënave për trajtimin e ankesave/kërkesave; shfaqja e informacionit në nën-domain të faqes zyrtare të ERE-s.	Frontend publik: React / Angular / Vue.js ose ekuivalente Backend/CMS: Java / .NET / Node.js / Headless CMS ose ekuivalente Database: PostgreSQL / SQL Server ose ekuivalente
Nr.	Emërtimi i Modullit	Funksionalitetet teknike kryesore	Teknologjia e rekomanduar
